



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Istog

Opština Istok

Municipal of Istog

KOMUNA E ISTOGUT

SHPALL ANKAND PUBLIK

Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim

Duke u bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale dhe Rregullores QRK Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe Vendimit të Kuvendit Komunal 01 Nr. 32/2019 të datës 29.03.2019 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, Komuna e Istogut:

Shpall Ankand Publik

Ftohen të gjithë personat fizikë dhe juridikë që janë të interesuar për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës e cila gjendet në Zonën Kadastrale në Tuçep që të aplikojnë në ankandin publik duke respektuar procedurën si më poshtë:

Lokacioni i pronës që është objekt i dhënies në shfrytëzim

- Jepet në shfrytëzim Njësia Kadastrale Nr. 00400-0, Zona Kadastrale në Tuçep, në sipërfaqe të përgjithshme prej 50947 m², e evidentuar me numër të certifikatës 549/2019, të datës 04.03.2019, si Pronë Shoqërore e Komunës së Istogut, në vendin e quajtur “ Grukë”
- Sipërfaqja e ofruar në ankand jepet për qëllim të zhvillimit ekonomik.

Çmimi fillestar i pronës që është objekt i dhënies në shfrytëzim përmes ankandit publik

- Çmimi fillestar për dhënien e tokës publike në shfrytëzim për metër katror do të jetë 0.03 € (tre centë) për një (1) vit.
- Përzgjedhja e fituesit bëhet në bazë të çmimit më të lartë të ofertuar në ankand publik.

Afati i dhënies në shfrytëzim

- Afati kohor për shfrytëzimin afatshkurtër të pronës së paluajtshme është pesëmbëdhjetë (15) vite.

Veprimtaria që do të ushtrohet

- Prona e dhënë përmes ankandit publik mund të shfrytëzohet për veprimtari të zhvillimit ekonomik, përkatësisht zhvillimin e aktivitetit bujqësor.

Afati i fundit për aplikim

- Ofertat mund të dorëzohen në afatin prej 30 ditëve duke filluar nga data e publikimit të ankandit publik. Afati i fundit për dorëzimin e ofertës do të jetë deri më 14.06.2019 deri në ora 13:30.

Data, koha dhe vendi i hapjes së ofertave

- Hapja e ofertave do të bëhet nga Komisioni Komunal për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale në prezencë të ofertuesve, më 14.06.2019 në ora 14.⁰⁰, në sallën e takimeve nr. 311, kati i tretë, në objektin e komunës.

Forma në të cilën do të mbahet ankandi publik

- Ankandi publik do të mbahet përmes ofertave të mbyllura.

Numri kontaktues, emaili, adresa për informacion shtesë:

- Personi kontaktues, Faton Bujupi; tel. zyrtar 049/766-714; emaili: faton.bujupi@rks-gov.net; kontakti çdo ditë pune nga ora 08⁰⁰-16⁰⁰.

Tërheqja e aplikacionit për të ofertuar në ankandin publik

- Formulari për të konkurruar në ankand mund të merret në formë fizike në zyrën numër 310 dhe atë elektronike në ueb faqe të Komunës www.rks.gov.net/istog

Personat të cilët aplikojnë në ankand publik për marrjen e pronës në shfrytëzim duhet të prezantojnë këto dokumente shtesë:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit (duke përfshirë numrin fiskal);
- Certifikatën e TVSH-së;
- Vërtetimin e tatimit në pronë;
- Dëshmitë mbi kryerjen e obligimeve ndaj komunës së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të ofertës;
- Planin e biznesit dhe
- Kopjen e letërnjoftimit.

Informatat shtesë dhe vizitat për shikimin e lokacionit mund të bëhen gjatë gjithë periudhës sa është i hapur ankandi publik (30 ditë) duke iu referuar zyrës së Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi.

Ofertat e mbyllura dhe të protokolluara duhet të dorëzohen në afatin e lartcekur në zyrën Nr.100, për shërbim të qytetarëve. Oferta duhet të jetë në origjinal me 2 kopje shtesë.

Të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga ky ankand publik përcaktohen me kontratë ndërmjet Komunës dhe fituesit të ankandit publik.

Komuna e Istogut,
Më 15.05.2019